



NJOFTIM PËR TË GJITHË KREDITORËT DHE PRONARËT E NDËRMARRJES

MIT124 Organizata Punuese për Mirëmbajtjen dhe Shfrytëzimin e Objekteve Sportive në Mitrovicë

Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:

Lëvizja e Organizatës për Kulturën Fizike – LOKFA
Samoupravna Interesna Zajednica za Fizicku Kulturu
Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit për Kultur Fizike
RO za Održavanje i Koriscenje Sportskih Objekata (Fi-8/82)
RO za Održavanje i Koriscenje Sportskih Objekata (Fi-258/82)
OP për Mirëmbajtjen dhe Shfrytëzimin e Objekteve Sportive
DP Sportski Centar – Titova Mitrovica (1991)

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe nenit 7 të Shtojcës të këtij ligji, **NJOFTOHENI** se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar me datë 12 janar 2017 në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 16 dhe 20 dhjetor 2016.

Çdo person i cili pretendon se ka të drejtë kërkesë dhe/apo interesi ndaj kësaj ndërmarrjeje apo aseti të ndërmarrjes duhet të parashtojë Dëshminë e Kërkesës përkatësisht Dëshminë e Interesit sipas nenit 7 në pajtim me nenin 23 të Shtojcës të Ligjit.

Afati për parashtrimin e kërkesave kreditore fillon me datë 23 janar 2017 dhe përfundon me datë 9 mars 2017 në orën 16:00.

Ftoheni që të parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit pavarësisht nëse më herët mund ta keni informuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit apo pararendësin e saj. Nëse nuk parashtroni Dëshminë e Kërkesës dhe Dëshminë e Interesit brenda afatit kohor të lartë cekur, pretendimet tuaja do të refuzohen si të papranueshme bazuar në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Mosdorëzimi i dokumentacionit mbështetës së kërkesës tuaj apo mosplotësimi i rregullt i formularëve, gjithashtu do të rezultojë në refuzimin e pretendimeve tuaja.

Formularët për Dëshminë e Kërkesës si dhe Dëshminë e Interesit mund të merren në të gjitha zyrat e AKP-së dhe duhet të dorëzohen në Zyrën Rajonale të AKP-së çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në ora 14:00 në adresën si më poshtë.

**Agjencia Kosovare e Privatizimit
Zyra Rajonale në Mitrovicë
Mbretëresha Teutë, pn (afër Sallës së Sporteve),
Mitrovicë, 40 000
Telefoni: +381 28 534 690
Fax: +381 28 534 590**

Formularët për parashtrim të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit gjithashtu mund të shkarkohen edhe nga faqja e internetit të AKP-së në adresën www.pak-ks.org. Për udhëzime se si të plotësohen dhe dorëzohen këta formularë referohuni tek seksioni **“Formularët-Udhëzime për plotësim”**. Formularët e dorëzuar përmes postës elektronike nuk do të pranohen.